



Bashkëpunimi Ndërkufitar

Durrës, Kukës, Gjakovë

Institute for Public and Private Policies

Publikuar nga: Friedrich Ebert Stiftung
Zyra e Tiranës
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Kutia postare 1418
Tirane, Albania

Autor: Instituti i Politikave Publike dhe Private

Ky material hedh një vështrim mbi mundësitë dhe potencialet për bashkëpunim të suksesshëm ndërkufitar.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	2
2. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rëndësia e tij	5
3. Parimet e Bashkimit Evropian	7
4. Përshkrimi i zonave të përzgjedhura	8
4.1 Zona e Durrësit	8
4.2 Zona e Kukësit	12
4.3 Zona e Gjakovës	16
5. Potencialet për bashkëpunim ndërkufitar	19
6. Konkluzione dhe rekomandime	23

1. Hyrje

Shqipëria është duke ndjekur disa reforma të rëndësishme që synojnë forcimin e demokracisë dhe rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social. Integrimi evropian është në qendër të këtyre reformave.

Reforma më e rëndësishme është Reforma Administrative dhe Territoriale (e miratuar më korrik 2014), e cila krijon një model të ri të njësive të qeverisjes vendore në nivelin e parë dhe krijon një bazë të mirë për ndarjen e përgjegjësisë dhe financave për shërbimet publike duke rritur pritshmëritë në nivel lokal. Kjo reformë synon të forcojë këto njësi duke rritur kapacitetin e tyre në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e efikasitetit të burimeve natyrore, financiare dhe njerëzore të këtyre njësive. Reforma territoriale është shoqëruar me Reformën e Decentralizimit, strategjia e së cilës është miratuar së fundmi (13 gusht 2015). Kjo strategji synon forcimin e qeverisjes vendore dhe përparimin në procesin e decentralizimit sipas standardeve evropiane.

Këto reforma janë komponentë kyç në sigurimin e qeverisjes së mirë, forcimin e ekonomisë, forcimin e komuniteteve nga pikëpamja sociale dhe nxitjen e vendit në procesin e integritetit evropian.

Shqipëria si një vend kandidat potencial, që prej vitit 2007 ka përfituar nga komponentët e Instrumentit të Para Aderimit (IPA), përkatësisht Komponenti I (Ndërtimi Institucional) dhe Komponenti II (Bashkëpunimi Ndërkufitar). Tashmë, Shqipëria e ka fituar statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian, duke hapur një perspektivë të re mundësish dhe duke u përgatitur për anëtarësim në BE dhe thithjen e fondeve të BE. Që nga marrja e këtij statusi Shqipëria mund të përthithë fonde nga komponentët III, IV dhe V të IPA-s, përkatësisht, Zhvillimin Rajonal, Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimin Rural.

Ndihma e BE-së për Shqipërinë e dhënë kryesisht nëpërmjet programit IPA është e rëndësishme, për rritjen e kapaciteteve vendase për të zbatuar projekte. Ky proces ndihmon vendin duke e përgatitur për të përfituar fondet Europiane dhe mbas anëtarësimit, prandaj ka një rëndësi të madhe se si Shqipëria i orienton dhe përthith këto fonde.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë elemente thelbësore të Procesit të Stabilizim Asociimit. Deri më tani, përvoja ka treguar se përfitimi nga Komponenti II (bashkëpunim ndërkufitar) pothuajse ka munguar pasi njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri ishin shumë të fragmentuara dhe me kapacitete të kufizuara për nxitjen dhe zbatimin e projekteve ndërkufitare në fushat e zhvillimit ekonomik, bujqësisë, turizmit, arsimit etj, por duke u fokusuar kryesisht në aktivitetet kulturore.

Reforma Administrative Territoriale sjell një qasje të re në mundësitë dhe kapacitetet për një bashkëpunim të suksesshëm ndërkufitar, pasi ajo do të ketë një ndikim jo vetëm në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe në rritjen e territorit, si një promotor për zhvillimin e NJQV-ve. Në një territor më të gjerë njësitë e qeverisjes vendore do të jenë në gjendje të përdorin më shumë instrumente për rritjen e bashkëpunimit me vendet fqinje. NJQV-të e reja duhet të zhvillojnë strategji autentike lokale për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet vendeve fqinje. Këto strategji për zhvillim duhet të jenë konkrete dhe të kenë prioritete të përcaktuara mirë.

Një objektiv i rëndësishëm i politikës së jashtme të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet politika rajonale. Shqipëria, si një aktor rajonal me një peshë dhe një rol të rëndësishëm, është i interesuar në stabilitetin e rajonit ku paqja, bashkëpunimi socio-ekonomik dhe shkëmbimet kulturore për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët e saj. Gjithashtu, si pjesë e përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare do të jetë plotësisht e angazhuar për forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në fusha të ndryshme.

Forcimi i qeverisjes vendore në mënyrë që të sigurohet një efikasitet më i lartë i saj është vizioni që ndjek parimet dhe standardet e përcaktuara në Kartën Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore. Sistemi i ri i pushtetit vendor ka hedhur themelet për një platformë të re për zhvillimin kombëtar dhe rajonal.

Një objektivi i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkufitar duhet të jetë promovimi i aktiviteteve të përbashketa duke përfshirë partnerë përtej kufijve dhe inkurajimi i sipërmarrjeve dhe investimeve për vendet fqinje. Kjo do të ndihmojë në uljen e nivelit të izolimit për këto vende dhe zhvillimin e bashkëpunimit në sektorë të ndryshëm. Është thelbësore që këto vende të intensifikojnë reformat për të arritur rritje të qëndrueshme dhe për të trajtuar sfidat e nevojshme për të përmbushur kriteret ekonomike dhe për të përmirësuar konkurrencën.

Objektivi i përgjithshëm i ndihmës financiare të BE-së në Shqipëri është të mbështesë reformat e saj për të siguruar përputhjen me ligjet e BE-së. Ky synim përputhet plotësisht me ndërtimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave për një fqinjësi të mirë.

Shqipëria në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të ofruara nga IPA CBC mund të marrë pjesë në Adriatik CBC IPA dhe IPA CBC Shqipëri-Kosovë. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar (CBC) IPA Adriatik synon të forcojë kapacitetet për zhvillimin e qëndrueshëm në zonën e Adriatikut. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC Shqipëri-Kosovë ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat kufitare dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e këtyre zonave në interesin e përbashkët të qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës.

Tani është koha e duhur për të hequr barrierat burokratike që kanë ekzistuar ndër vite, në mënyrë që të përdoren fondet e BE-së, të cilat ndikojnë në përmirësimin e kushteve të komuniteteve në zonat kufitare. Diskutimi mbi një çështje të tillë në qytetet shqiptare të Kukësit dhe Durrësit dhe

qytetit të Gjakovës në Kosovë, do të jetë shumë e rëndësishme për çeljen e diskutimeve mbi mundësitë dhe potencialet për bashkëpunim ndërkufitar.

2. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rëndësia e tij

Bashkëpunimi ndërkufitar është një element i rëndësishëm i procesit të integritit evropian. Prandaj, bashkëpunimi i suksesshëm mes Shqipërisë dhe Kosovës, dhe me fqinjët e tyre të tjerë është një element i rëndësishëm i asistencës së IPA. Bashkëpunimi ndërkufitar është i nevojshëm për të përmirësuar zhvillimin ekonomik lokal dhe për të nxitur kontaktet mes njerëzve në zonat kufitare, duke përfshirë autoritetet lokale dhe rajonale, si dhe të gjitha palët e interesuara. Programet ndërkufitare përqendrohen në nivel lokal në të dyja anët e kufirit, duke ndihmuar njerëzit të adresojnë çështje me interes të përbashkët.

Programet e bashkëpunimit ndërkufitar paraqesin kornizën për integrimin e shpejtë ekonomik, duke synuar uljen e dallimeve ekzistuese duke përfunduar lidhjet ekonomike, sociale, mjedisore dhe kulturore.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore mund të zhvillohen duke përfshirë përfaqësues nga të dyja anët e kufirit, të cilët do të vendosin një program të përbashkët bashkëpunimi, duke iu përmbajtur një grup rregullave të caktuara. Pra, këto programe projektohen bashkërisht nga dy vendet fqinje në mënyrë që të trajtohen problemet e përbashkëta dhe të shfrytëzojnë potencialet e përbashkëta.

Duke njohur nevojën për të ndihmuar përpjekje të bashkëpunimit në nivel rajonal, Komisioni Evropian filloi projektin CBIB – Cross Border Institution Building (Projekti Ndërkufitar i Ndërtimit të Institucioneve) në qershor 2006. Programet janë të financuara nga Bashkimi Evropian (BE) në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para Aderimit (IPA). Sic, u përmend edhe më lart IPA është i zbatueshëm për vendet candidate dhe vendet potenciale candidate, si

dhe në shtetet anëtare, të cilat ndajnë një program ndërkufitar me këto vende. Tre prioritetet kryesore të programeve të bashkëpunimit janë:

- 1) Zhvillimi ekonomik dhe social;
- 2) Menaxhimi i qëndrueshem i burimeve natyrore;
- 3) Asistencë teknike.

Rezultati përfundimtar i projekteve duhet patjetër të jetë prosperiteti ekonomik i rajoneve ndërkufitare, siguria politike dhe siguria në rajon, dhe një proces më i lehtë dhe i shpejtë i integritetit evropian.

Shqipëria dhe Kosova janë pjesë e vendeve të Ballkanit perëndimor, të cilat kanë kuptuar se kanë përgjegjësi ndaj njëra tjetrës, për shkak të sfidave të përbashkëta, afërsisë së natyrshme që ato kanë dhe potencialeve të konsiderueshme për bashkëpunim. Kjo vendosmëri e re për të adresuar çështjet me rëndësi të përbashkët në një mënyrë bashkëpunuese duhet të pasqyrohet në veprime dhe projekte konkrete. Programet e bashkëpunimit, të cilat kontribuojnë në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të jenë në një linjë me ligjet, politikat dhe strategjitë e aprovuara në nivel lokal dhe kombëtar në Kosovë dhe Shqipëri, dhe duhet të kenë mbështetje të gjerë .

Mundësi të reja paraqiten përmes programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, për të cilat mungon përvoja e kaluar. Nismat e bashkëpunimit ndërkufitar mund të bëhen mjete të rëndësishme për të lehtësuar zhvillimin rajonal dhe përfshirjen sociale brenda Qarkut të Kukësit, Qarkut të Durrësit dhe më vonë në një rajon më të gjerë.

3. Parimet e Bashkimit Evropian

Parimi 1: Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Parimi i qëndrueshmërisë synon sigurimin e kushteve për zhvillimin e brezave të tanishëm, pa zvogëluar mundësitë për zhvillimin e brezave të ardhshëm. Për të arritur në këtë pikë, duhet të merren parasysh tre dimensione të qëndrueshmërisë, përkatësisht, mjedisor, ekonomik dhe ai social.

- Qëndrueshmëria mjedisore do të thotë, përdorimi i duhur i cilësisë së mjedisit, përmirësimi i cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e biodiversitetit dhe parandalimin e rrezikut për njerëzit dhe mjedisin.
- Qëndrueshmëria ekonomike nënkupton krijimin e një sistemi ekonomik të orientuar dhe një rritje të vazhdueshme të aftësisë ekonomike dhe mundësitë për risi.
- Qëndrueshmëria shoqërore do të thotë ekuilibër social, të drejtën për jetën dhe pjesëmarrjen aktive të popullsisë në bërjen e politikave.

Parimi 2: Promovimi i mundësive të barabarta dhe jo-diskriminimit

Programet e bashkëpunimit ndërkufitar, gjithashtu duhet të jenë në një linjë dhe në përputhje me politikat kombëtare dhe europiane të mundësive të barabarta dhe jo-diskriminimit. Mundësitë e barabarta duhet të jenë parim themelor i çdo aktiviteti dhe përfshirja e mundësive të barabarta në të gjitha aktivitetet do të sjellë balancë dhe drejtësi në shoqëri.

Në përputhje me objektivat dhe politikat e BE-së, programet duhet të ndjekin parimet horizontale të partneritetit ndërkufitar, të pronësisë vendore dhe mundësive të barabarta, duke siguruar që të respektohen dhe përfshihen në hartimin dhe zbatimin e projekteve çështjet e ndërlidhura, siç janë mos diskriminimi i grupeve të pakicave dhe grupeve të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore, dhe qeverisja e mirë.

4. Përshkrimi i zonave të përzgjedhura

Durrësi, Kukësi dhe Gjakova janë një shembull i mirë i forcimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë përmes iniciativave të përbashkëta në zonat kufitare. Fokusi i programeve ndërkufitare janë qëndrueshmëria ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, kështu që për të arritur në konkluzionin se cilat janë potencialet për bashkëpunim ndërkufitar në Kukës, Durrës dhe Gjakovë është e rëndësishme të analizohen së pari disa çështje kryesore:

- Gjeografia dhe Mjedisi
- Popullsia
- Ekonomia
- Punësimi dhe fuqia punëtore
- Infrastruktura
- Kultura dhe Turizmi

4.1 Zona e Durrësit

Gjeografia dhe Mjedisi

Durrësi shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparet e kësaj zone si zonë turistike.

Durrësi ka një rëndësi të madhe strategjike. Durrësi është i vendosur në brigjet e detit Adriatik rreth 33 km, në perëndim të kryeqytetit, Tiranës. Ai ndodhet përballë porteve të rëndësishme italiane si ai I Barit dhe Brindisit. Durrësi është gjithashtu pikënisja e korridorit 8, si dhe

kryqëzim i linjave më të rëndësishme të rrugëve, ku më e rëndësishmja është linja Durrës - Kukës - Morinë e cila lidh Shqipërinë me Kosovën.

Bashkia e re Durrës me qendër qytetin e Durrësit përbehet nga pesë njësi vendore ekzistuese: bashkia Durrës, bashkia Sukth dhe komunat e Rrashbullit, Katundit të Ri dhe Ishmit. Katër njësitë e reja kanë një lidhje të natyrshme territoriale me qytetin e Durrësit, dy nga të cilat janë njësi kufitare me qytetin e Durrësit, katër prej tyre shtrihen në bregdet ose menaxhojnë një pjesë të bregut duke ndarë interesa të përbashkëta në zhvillime infrastrukturore, urbane, mjedisore dhe industriale, orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, industrisë fasone dhe asaj përpunuese.

Popullsia

Bashkia e re e Durrësit ka një popullsi prej 168'458 banorësh. Popullsia është homogjene dhe me traditë shkëmbimesh kulturore të ndërsjella. Edhe pse katër njësitë kontribuojnë me 87% të sipërfaqes së zonës ato përbëjnë vetëm 33% të popullsisë të të gjithë zonës duke e çuar dendësinë e zonës në 571 banorë/ km². Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Ekonomia

Sipas të dhënave të ofruara nga Instituti i Statistikave në lidhje me Prodhimin e Brëndshëm Bruto (PBB) rajonal, Durrësi është një nga rajonet më të rëndësishme pas Tiranës, me 9.4% të vlerës së shtuar në mbarë vendin. Në nivel rajonal, PBB për frymë është 3.276 euro.

Durrësi është një nyje lidhëse e rëndësishme me Evropën Perëndimore për shkak të portit dhe afërsisë me portet italiane të Barit dhe Brindisit, të cilët kanë lëvizshmëri të madhe të trageteve. Durrësi gjithashtu posedon një kantier detar dhe industritë prodhuese sidomos prodhimin e lëkurave, plastikës dhe prodhimeve të duhanit.

Porti proçeson më shumë se 90% të gjithë mallrave që importohen dhe eskportohen, duke u bërë nyja më e rëndësishme tregtare në vend. Për shkak të lehtësirave që krijon porti, Durrësi është zhvilluar si një qytet i rëndësishëm për prodhimin, duke sjellë gjithashtu një bum në sektorin e ndërtimit.

Përqendrimi gjeografik i ndërmarrjeve korrespondon me të dhënat mbi zhvillimin ekonomik: më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të përgjithshme (52%) dhe ndërmarrjet e mëdha (56%) operojnë në seksionin Tiranë - Durrës, por me një përqendrim më të lartë në rajonin e Tiranës. Me mbi 5600 aktivitete ekonomike dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi renditet si vend i rëndësishëm ekonomik, pas Tiranës.

Përsa i përket plazheve, vija bregdetare e Golemit, e njohur për plazhet massive dhe zhvillimin e turizmit ka përjetuar zhvillim të pakontrolluar urban. Plazhet e qytetit janë gjithashtu një destinacion popullor për shumë turistë të huaj dhe vendas, me një vlerësim rreth 800.000 turistë çdo vit. Nga ana tjetër, shtrihet bregdeti i Gjirit të Lalzit, i cili më së shumti është i pa dëmtuar dhe me potenciale për t'u bërë një destinacion turistik elitë.

Punësimi dhe fuqia punëtore

Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10.38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31.3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36.7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

Qyteti i Durrësit para konsolidimit të Reformës Administrative Territoriale numeronte 4,401 subjekte ku ishin punësuar 27,737 punonjes. Tashmë, sektori ku janë të punësuar pjesa më e madhe prej 7,626 persona (ose 27.5 % e numrit total të personave të punësuar) është industria përpunuese me rreth 403 subjekte.

Edhe pse me pozitë gjeografike të favorshme dhe me tradita të hershme turistike e tregtare, qarku Durrës ka një nivel varfërie më të lartë se sa mesatarja e vendit.

Infrastruktura

Zona ka një infrastrukturë të zhvilluar në sajë të pozicionit të saj strategjik në zonën qendrore të detit Adriatik dhe shërben si nyje e rëndësishme e transportit të udhëtarëve dhe mallrave për të gjithë vendin, për rrjedhojë edhe për vetë banorët e zonës. Një pjesë e saj përshkohet nga rrugë kombëtare të rëndësishme, si autostrada Tiranë-Durrës, rruga Durrës-Kukës, etj.

Kultura dhe turizmi

Bashkia e Re e Durrësit është një nga zonat gjeografike më të pasura në këndvështrimin historik dhe kulturor. Si porta e hyrjes në Shqipëri, qyteti i Durrësit ofron eksperiencën dhe përshtypjen e parë të turistëve që vijnë në Shqipëri nga deti.

Durrësi është një qytet me kulturë të hershme, për shkak të origjinës së tij të lashtë. Qyteti ka trashëguar mjaft vlera të së kaluarës, qendra historike dhe arkeologjike si Amfiteatri, rrethoja bizantine, Kulla Veneciane, muri rrethues i kalasë dhe gjithashtu qendra kulturore e fetare si rrënojat e Bazilikës në Arapaj, kështjella e Rodonit etj. Në Durrës gjenden një rradhë muzesh dhe monumentesh si: Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnografik, Monumneti i Mujo Ulqinakut, Mozaiku i Orfeut etj.

Gjithashtu në Durrës organizohen mjaft aktivitete në rang kombtar e ndërkombëtar si Festivali Ndërkombëtar i Filmit (Durrës International Film Festival), Festivali muzikor i jazz-it, Konkursi i poezisë Poeteka, Festivali Ndërkombëtar i Dansit Modern, Maratona e Këngës Popullore dhe Qytetare, Festa e Ullirit, Panairi Veror i Librit etj.

Durrësi është i famshëm për plazhin e tij, plazhi më i madh kombëtar me një gjatësi lineare prej 4 kilometra nga Ura e Dajlanit deri Shkëmbit të Kavajës. Ai është i njohur për rërën e butë dhe

rripin e gjerë të rërës të shfrytëzueshëm në një gjerësi prej 150-180 metrash. Karakteristika kryesore e këtij plazhi është rritja graduale e thellësisë së detit, gjë që e bën ideal për të notuar dhe shijuar rrezet e diellit.

Plazhi i Golemit shtrihet si një zgjatim i plazhit të Durrësit. Ai gjithashtu ka rërë të butë, rrip të gjerë me rërë dhe rritje graduale të thellësisë së detit. Hotelet luksoze dhe resortet, të cilat kohët e fundit janë ndërtuar atje, infrastruktura e përmirësuar dhe shërbimet ndryshme e ofruara e kanë bërë këtë plazh popullor dhe pikë atraksioni kryesore për shumë njerëz nga Shqipëria, turistë nga Kosova, Maqedonia dhe vende të tjera. Ka edhe shumë plazhe të tjera si plazhi i Spillesë, plazhi i Gjeneralit, plazhi Portëz etj

Përveç bukurisë që ofrojnë plazhet dhe numrit të madh të turistëve që tërheqin, ata kanë disa probleme të tilla si numri i kufizuar i tualeteve publike dhe shkarkimi i ujërave të zeza, i cili vazhdon të shkaktojë ndotje detare dhe shqetësime shëndetësore për pushuesit.

4.2 Zona e Kukësit

Gjeografia dhe mjedisi

Kukësi shtrihet në zonën verilindore dhe kufizohet nga Kosova në lindje dhe verilindje, në veri me Hasin, Pukën dhe Mirditën në perëndim dhe Dibrën në jug. Relievi në këtë zonë është kryesisht malor. Kjo zonë është e pasur me vargje malore, fusha, lugina, lumenj, liqene dhe monumente të shumta natyrore. Toka është e pasur me minerale si krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, rërë kuarci, mermer etj.

Të gjitha këto burime ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit dhe industrisë së drurit, por gjithashtu pengojnë infrastrukturën e transportit dhe komunikimit me fqinjët. Prandaj është i nevojshëm bashkëpunimi ndërkufitar dhe zbatimi i projekteve të ndryshme me interes të përbashkët për të eliminuar këto pengesa dhe për të zhvilluar të gjithë zonën.

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit dhe biodiversitetit duhet të jenë në fokus të veçantë, pas dëmtimeve në mjedis që kanë të bëjnë me pyjet (shpyllëzimin) dhe ndotjen e ujit për shkak të hedhjes së mbetjeve në liqenin e Fierzës. Rreziku i shpyllëzimit ekziston për shkak të prerjes së pakontrolluar të pemëve, lumenjte dhe liqenet po ndoten nga depozitimi i mbetjeve industriale dhe urbane dhe menaxhimi i dobët i tyre, pesticidet përdoren në mënyrë intensive në bujqësi, dhe së fundmi fauna është e kërcënuar nga peshkimi dhe gjuetia ilegale.

Popullsia

Sipas Censusit të vitit 2011, popullsia në Bashkinë e re Kukës është 47,985 banorë. Bashkia e re me një sipërfaqe prej 933.86 km² dhe një densitet prej 63.59 banorë/km² përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh.

Një tendencë e rëndësishme e vëne rë në zonën e Kukesit është shpopullimi i përgjithshëm i ndjekur nga migrimet nga zonat rurale në qendrat urbane. Vitet e fundit popullsia në zonat urbane u rrit me 3.8%, ndërsa në zonat rurale ka rënë me 2.5%. Faktorët kryesorë që kanë kontribuar në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi; infrastrukturën e transportit dhe të komunikimit jashtëzakonisht të dobët; terreni në përgjithësi i vështirë; kushtet e pafavorshme klimatike dhe bujqësore; si dhe shfrytëzimi pa kriter të pyjeve.

Ekonomia

Kukësi njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujqor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si

dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri, por transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë të falimentojë tërësisht. Kjo shkaktoi shumë plagë sociale, duke krijuar një numër të madh të papunësh. Moszgjidhja në kohë e problemeve të pronësisë mbi tokën shkaktuan shumë konflikte pronësie dhe bllokuan tërësisht nismat e biznesit vendas dhe atij të huaj, duke krijuar një ngërç absurd që ende sot e kësaj dite vazhdon të mbajë nën tension shumë prej banorëve të Kukësit.

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë janë dy sektoret kryesorë, të cilët promovojnë zhvillimin ekonomik të zonës dhe përmirësimin e jetesës. Rajoni i Kukësit mund të zhvillojë delen e llojit Rudë, e cila është karakteristike për këtë zonë.

Industria ushqimore është e mbyllur vetëm për prodhimin e pijeve alkoolike të prodhuara në një fabrikë pijesh, dhe në disa punëtori të vogla lokale që prodhojnë pije dhe produktet e qumështit. Kukësi ka një fabrikë për prodhimin e qilimeve, të cilat janë për përdorim të brendshëm dhe për tregti. Ekziston edhe një fabrikë e përpunimit të bakrit, i cili është gjetur në këtë vend si lëndë e parë. Kukësi gjithashtu është një qendër e mirë për peshkim dhe për ecje në natyrë në malet përreth.

Bashkia e Kukësit ka një total biznesesh (ku përfshihet biznesi i madh, i mesëm, i vogël dhe të tjera) prej 770 biznesesh, ndërsa ish-komunat paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Kjo është një diferencë shumë e madhe që tregon se niveli ekonomik është shumë i ulët, pasi numri i bizneseve që është tregues i rëndësishëm i ekonomisë së njësive vendore, është shumë i vogël.

Punësimi dhe fuqia punëtore

Në zonat rurale, sektori i bujqësisë ka punësuar shumicën e të punësuarve. Qyteti i Kukësit ka parë zhvillim që prej hapjes së autostradës, duke rritur bashkëpunimin me bizneset në Kosovë dhe duke hapur biznese të reja.

Ky është një tregues i trendit të rritjes së ekonomisë dhe ka sjellë reduktim të numrit të të papunëve. Gjatë punimeve të autostradës papunësia në Kukës ka pësuar shumë ndryshime, duke u ulur ndjeshëm pasi u punësuan një numër i madh i njerëzve në këto zona. Por mos funksionimi i politikave rajonale të punësimit bën që niveli i punësimit të vazhdojë të mbetet i ulët.

Infrastruktura

Në këtë zonë kalon autostrada Durrës - Morinë e cila është pjesë e aksit rrugor kombëtar që lidh Shqipërinë me Kosovën. Pjesa më e madhe e fshatrave të bashkisë së re nuk janë ende të lidhura me rrugë të asfaltuara, ndërsa rrugët e paasfaltuara janë të degraduara.

Kultura dhe turizmi

Kukësi ka histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri produktesh bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e turizmit në vend (eko-turizmit, turizmit malor, etj).

Ka një gamë të gjerë veprimtarish kuturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë si festivale, konkurse letrare, panaiere, ekspozita, festa e ditë festive (si Festa e Gështenjës, Festa e Patates, Dita e Artizanatit, Festa e Mjaltit, etj.), konferenca, javë arti, kampionati i skive në Shistavec, peshkim e lundrim, alpinizëm, kampingje, përfshirë evenimente ndërkufitare me Kosovën të cilat e pasurojnë jetën artistike e sportive të zonës.

Kukësi është i pasur me muze e monumente, tradita dhe folklor, të cilat janë bërë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare: Banesa e Hasan Rexhepit, Kështjella e Bushatit, Shkolla e Vjetër e Bicajve dhe Kalaja e Vilës, ndërtesa fetare etj.

Kjo Zonë ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullosat alpine, luginat e thella, lumenjt, liqenet, shpellat etj), të cilat i shtojnë potencialet për ta shndërruar Kukësin në një zonë të frekuentuar turistike për të zhvilluar më tej aktivitetet ndryshme dhe sportet që mund të zhvillohen në këtë zonë.

Megjithatë, niveli i turizmit është shumë modest. Kjo është për shkak të kombinimit të faktorëve të shumtë si: aksesit i kufizuar, kushte e këqija të infrastrukturës (rrugëve, energjisë, furnizimit me ujë, infrastruktura e turizmit etj), planifikimi urban i varfër, dëmtimi i pyjeve dhe problemeve të tjera mjedisore, niveli i ulët i shërbimeve për turistëve si standardet e akomodimit, marketing i papërshtatshëm dhe mungesa e informacionit apo guidave turistike.

4.3 Zona e Gjakovës

Gjeografia dhe mjedisi

Komuna e Gjakovës, e pozicionuar në perëndim të Kosovës, në një lartësi prej 335 metër shtrihet në mes të lumenjve Ereniku, Krena e Llukaci, dhe është e pasur me shumë burime natyrore dhe njerëzore, të mjaftueshme për zhvillimin e saj. Gjakova shtrihet në zonën gjeografike të Dukagjinit, e cila është e vendosur në mes të maleve të Nemuna, Pashtriku, Mokra Gora dhe Sharrit.

Luginat e lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Trava dhe Llukaci dhe disa nga degëzimet e tyre, përbëjnë bimësinë dhe shumë fusha pjellore të kësaj zone. Natyra dhe peizazhi e bëjnë Gjakovën një rajon shumë të ndryshëm dhe të pasur.

Një pjesë e konsiderueshme e Gjakovës është e mbuluar me pyje, kryesisht në verilindje dhe pjesën perëndimore. Me këto pyje përreth, me malet, kullotat malore, në pjesët perëndimore, me fushat dhe tokat bujqësore në pjesën lindore, dhe me lumenj të shumtë, Gjakova ofron diversitet të pasur mjedisor me mundësi të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm të saj.

Popullsia

Sipas Census 2011 në Kosovë, popullsia totale është 94,556 banorë dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 586 km². Niveli i migrimit në Kosovë, në mënyrë të veçantë migrimi i brendshëm është i lartë. Shkaku kryesor është papunësia. Tendenca e lëvizjes së popullsisë është drejt zonave urbane, pasi atje ka mundësi më të mëdha punësimi.

Ekonomia

Gjakova ka një traditë shekullore të aktiviteteve ekonomike duke filluar me zejtarinë, tregtinë, bujqësinë, blegtorinë, dhe ka zhvilluar më tej industrinë tekstile sidomos përpunimin e lëkurës, metaleve etj.

Bazuar në mjedis dhe kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial të madh zhvillimi për ekonominë. Aktualisht, prodhimi bujqësor dominohet nga kultura e misrit dhe grurit. Një tjetër potencial i rëndësishëm zhvillimi janë sipërfaqet e livadheve dhe kullotave. Pemishtet janë relativisht të zhvilluara në territorin e Gjakovës, dhe gjithashtu është i zhvilluar grumbullimi dhe përpunimi i llojeve të ndryshme të këtyre produkteve të tilla si mollë, dardha, qershi, luleshtrydhe, manaferra, kajsia, etc. në një sipërfaqe rreth 13,861 ha. Pyjet mbulojnë një sipërfaqe mbi 20 mijë ha.

Gjakova ka një traditë të vjetër në kultivimin e rrushit. Vreshtaria si një aktivitet i rëndësishëm, për kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verës ka ndikim në ekonomine e zonës. Ekonomia e

Gjakovës është e bazuar kryesisht në bizneset e vogla. Ka rreth 6.260 biznese të regjistruara dhe që operojnë në sektorin privat dhe publik.

Qeveria e Gjakovës është e angazhuar për të krijuar kushtet e duhura për bizneset në mënyrë që të arrijnë sukses. Gjakova ka një rritje ekonomike dhe është renditur një prej ekonomive lokale më premtuese në Kosovë.

Punësimi dhe fuqia punëtore

Ka rreth 17.000 persona të punësuar në sektorin privat dhe publik. Gjithashtu, ka njerëz të vetë punësuar në bujqësi. Gjakova është e njohur për një traditë të punës në industri dhe bujqësi, si dhe në sektorë si zëjtaria, tregtia dhe shërbimet. Gjakova ka një strukturë të re të popullsisë dhe me një vullnet të shquar dhe të përkushtuar për punë. Këta faktorë paraqesin një potencial të madh zhvillimi për të ardhmen.

Infrastruktura

Statusi i përgjithshëm i infrastrukturës në Gjakovë është vlerësuar si i mirë. Shumica e rrugëve rajonale janë të shtruara. Gjakova ofron një pozicion shumë të përshtatshëm për aksesin e lehtë në tregjet në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin.

Kultura dhe turizmi

Rreth 320,000 m² parqe natyrore dhe rreth 50.000 m² parqe urbane janë të vendosura në Gjakovë, të cilat janë një potencial i madh për zhvillimin e turizmit. Asnjë nga këto parqe nuk e ka një status të veçantë të mbrojtjes. Përveç kësaj mirëmbajtja e tyre është në një nivel shumë të ulët.

Monumentet historike në Gjakovë janë të ndara në tre kategori të bazuara në kontekstin kulturor, fetar dhe social. Pjesa kryesore e qytetit është krijuar mes lumit Krena në lindje dhe kodrave në perëndim.

Me zhvillimin e shpejtë të tregtisë në qytet, disa bujtina janë ndërtuar për të pritur të vizitorëve të shumtë. Për shkak të origjinës së saj të lashtë dhe të zhvillimit të shpejtë ekonomik, Gjakova ka një rëndësi të madhe historike.

Evente dhe festivale në Gjakovë nuk janë të shumtë në numër. Qyteti historik i Gjakovës, Kosovë, sidomos Çarshia e Vjetër, është qendër e festivaleve të hapura dhe të mbyllura, ngjarjeve kulturore, paradave në rrugë etj. Shumë prej tyre janë sezonale dhe bëhen vetëm një herë, ndërsa të tjerë organizohen çdo vit duke u bërë një atraksion për turistët vendas dhe të huaj.

Gjakova po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë në sajë të bukurive natyrore, vlerave kulturore dhe monumenteve historike, shumë prej të cilave datojnë në shekullin e 17-të.

5. Potencialet për bashkëpunim ndërkufitar

Afërsia natyrore mes Shqipërisë dhe Kosovës dhe traditat e shumta të tyre të përbashkëta ofrojnë mundësi të shumta për bashkëpunim të suksesshëm përtej kufijve.

Prodhimet vendase nga të dyja anët e kufirit kanë pak ose aspak qasje në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Mekanizmat për mbështetjen e biznesit janë të dobëta dhe të pamjaftueshme. Aktivitetet ekonomike ndryshojnë nga një zonë në tjetrën. Bujqësia, tregtia, ndërtimi dhe përpunimi i ushqimit gjenerojnë shumicën e të ardhurave vendore. Në industrinë ushqimore, mungesa e standarteve të paketimit, të marketingut, gjetja e tregjeve etj janë kufizime ende të mëdha për zhvillimin e ardhshëm.

Zona juglindore, e cila përfshin Kukësin dhe Gjakovën, është e pasur me burime nëntokësore, disa prej tyre ende të pashfrytëzuara. Në Kukës, industria e bakrit, dikur shumë e rëndësishme për zonën dhe ekonominë e vendit, sot është bërë e parëndësishme dhe aktualisht të gjitha minierat janë të mbyllura. Shumica e produkteve bujqësore janë për vetë-konsum dhe një pjesë e mirë e prodhimit të Kosovës tregtohet në anën shqiptare të kufirit, kryesisht në rajonin e Kukësit, ku bujqësia është e dobët për shkak të kushteve të vështira natyrore dhe zonave malore.

Ka disa ushqime tipike dhe tradicionale: të qumështit dhe produkteve të mishit (djathë dele, kaskaval dhe mish qengji), fruta dhe perime të tilla si fasule, patate, qepë dhe gështenja, si dhe pije alkolike në zonën e Kukësit dhe verërat në rajonin e Gjakovës të njohura si shumë të veçanta.

Prandaj, duhet të gjenden mekanizma bashkëpunimi për të nxitur lulëzimin e këtyre industrive dhe rrjedhimisht uljen e papunësisë, rritjen e shkëmbimeve tregtare përtej kufijve dhe të aktivitetit ekonomik për ta kthyer këtë zonë, në një zonë të rëndësishme dhe të zhvilluar.

Turizmi, për shkak të burimeve të ndryshme dhe tërheqëse natyrore, ka një potencial të fortë për rritjen dhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik në të gjithë zonën, dhe ofron shumë mundësi për bashkëpunim ndërkufitar. Të gjitha rajonet, Kukësi, Durrësi dhe Gjakova ofrojnë një larmi karakteristikash, si: natyrën e bukur, peisazhet spektakolare, traditat dhe folklori, vendet kulturore dhe historike të përshtatshme për aktivitete turistike dhe kulturore. Malet, parqet kombëtare, zonat e mbrojtura dhe pyjet e njohur për bukurinë e tyre mund të jetë me interes të madh për turistët dhe ofrojnë mundësinë për të organizuar sporte dimërore dhe sporte në natyrë. Vija bregdetare, liqenet dhe lumenjtë e shumtë ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për turizëm bregdetar dhe sporte të ndryshme ujore.

Turizmi mund të gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme, por kërkon investime në infrastrukturë dhe në kapacitetet njerëzore dhe hartimin e strategjive dhe politikave të përshtatshme për këto zona potenciale për zhvillim.

Përsa i përket infrastrukturës, aktualisht ka gjashtë pika kalimi kufitar mes Shqipërisë dhe Kosovës. Nga këto, tre (Shishtavec / Kukës, Orgjose / Kukësi dhe Borje / Kukës) janë vetëm për këmbësorët, ndërsa tre janë për transportin e mallrave dhe automjeteve (Morinë / Kukës, Qafa Prush / Kukës dhe Qafë Morinë / Tropoje, nga të cilat një kalon në autostradën mes Kukësit dhe Prizrenit, dhe dy të tjera në rrugët kufitare që lidhin qarkun e Kukësit me Gjakovën dhe Pejën në Kosovë).

Investimet në një infrastrukturë moderne hedhin themelet për zhvillim ekonomik dhe rritjen ekonomike dhe afrojnë vendet dhe popujt përmes shkëmbimeve tregtare, aksesimit më të lehtë të tregjeve dhe gjithashtu nxisin zhvillimin e turizmit.

Rruga Durrës-Kukës-Morinë ka një rëndësi të vacantë sepse mundëson zhvillim më të shpejtë ekonomik, tregtar dhe turistik. Kjo rrugë lidh Kosovën dhe Shqipërinë dhe mundëson daljen në det për Kosovën. Gjithashtu ka krijuar një lirshmëri mjaft të madhe të njerezve dhe do të ndihmojë bashkëpunimin mes dy vendeve duke krijuar një tjetër infrastrukturë turizmi, tregtie dhe përfitimi ekonomik. Autostrada gjithashtu lidh qarkun e Kukësit me qytetin e Prizrenit në Kosovë, por edhe me qendrat e mëdha urbane në Shqipëri, duke përfshirë kryeqytetin Tiranë, portin e Durrësit, Shkodrën. Kanë filluar punimet për ndërtimin e autostradës në anën e Kosovës me qëllim vazhdimin e rrugës deri në Prishtinë.

Si përfundim mund të themi se kjo rrugë lehtëson shkëmbimet tregtare dhe rrit perspektivat e zhvillimit të turizmit. Kukësi duhet të përfitojë nga kjo rrugë e re duke zhvilluar kapacitetet vendore, duke përdorur burimet e rajonit në një treg konkurrues dhe duke nxitur iniciativat e bashkëpunimit ndërkufitar.

Duke pasur parasysh kushtet specifike natyrore, çështjet e mbrojtjes mjedisore kanë një prioritet të lartë. Degradimi i tokës është i pranishëm në të gjithë zonën. Mjedisi është i kërcënuar nga menaxhimi i dobët i ujit dhe kanalizimeve, hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, urbanizimit dhe nga ndotja industriale që ka shkaktuar dëme të mëdha mjedisore. Por, të treja zonat janë të pasura me biodiversitet dhe burime natyrore. Mbrojtja dhe vlerësimi i këyre asete është padyshim një nga pikat kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mund të ofrojë mundësi të shumta për bashkëpunim ndërkufitar.

Kultura është një aspekt i rëndësishëm që mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, në mënyrë që të përcjellë vlerat e përbashkëta kulturore dhe historike. Sidomos gjatë dekadës së fundit lidhje të ndryshme janë ngritur përtej kufirit në biznes, aktivitete kulturore dhe sociale, megjithëse kryesisht kanë qenë në baza ad-hoc. Këto marrëdhënie janë zhvilluar në mënyrë spontane dhe ka disa shkëmbime kulturore që tentojnë të konsolidohen në një frekuencë të rregullt të tilla si Dita e Verës, Dasma Kuksiane, etj

Çdo zonë është e pasur me objekte fetare dhe monumente historike, tradita dhe folklor. Ngjarje të shumta kulturore, festivale që janë organizuar dhe traditat e ndryshme në fushën e kulinarisë dhe zejtarisë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e turizmit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Trashëgimia kulturore është një nga pasuritë më të rëndësishme për perspektivat e zhvillimit. Promovimi kulturor dhe trashëgimia, gjithashtu mund të ofrojë mundësi të ndryshme për punësim dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

Ekzistojnë lidhje shumë të forta midis dy popujve në të dy anët e kufirit, të cilat rrjedhin nga gjuha e përbashkët, historia, nga rrënjët e thella të përbashkëta, marrëdhëniet kulturore dhe shkëmbimet tregtare që kanë lidhur këto territore dhe banorët e tyre për shekuj.

6. Konkluzione dhe rekomandime

- Si përfundim, theksojmë faktin se programet ndërkufitare kanë për qëllim rritjen e standartit të jetesës së popullsisë duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal në zonat kufitare.
- Zhvillimi ekonomik është aspekt vendimtar për një rajon për të prodhuar punë për njerëzit e tij dhe për të arritur qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për rritjen e besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve dhe vendeve.
- Qëllimi i përgjithshëm i bashkëpunimit ndërkufitar është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në rajonin ndërkufitar. Veprimet e përbashkëta dhe projektet ndërkufitare duhet të kenë një ndikim në gjendjen socio-ekonomike, forcimin e kohezionit social, nxitjen e menaxhimit të përbashkët dhe vlerësimin e traditave dhe burimeve kulturore dhe natyrore, rritjen ekonomike në zonat me potencial të mirë për zhvillim, të tilla si turizmi, dhe përmirësimin e kushteve mjedisore.
- Produktet tradicionale të këtyre zonave nëse tregtohen në mënyrën e duhur, mund të kontribuojnë në forcimin e identitetit të zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Produktet e ndryshme ushqimore tradicionale mund të luajnë një rol edhe në zhvillimin e turizmit, duke tërhequr turistë të shumtë.
- Përsa i përket bujqësisë, një politikë e qartë bujqësore, një menaxhim më i mirë i tokës, përmirësimi i skemave të ujitjes dhe infrastruktures mbeten sfidat kryesore dhe parakushte për një zhvillim efikas të bujqësisë në zonën kufitare të Kukësit dhe Gjakovës.

-
- Është e rëndësishme rritja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara përmes qasjeve të përbashkëta për mbështetjen e aktiviteteve ekonomike lokale, për zhvillimin e burimeve njerëzore duke pasqyruar nevojat e zones, duke i dhënë vëmendjen e duhur mbrojtjes dhe promovimit të mjedisit dhe dukë nxjerrë të gjithë potencialin kulturor dhe turistik të zonave kufitare, si një mjet për zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe realizimin e një bashkëpunimi të suksesshëm ndërkufitar.